



BULETINI MUJOR

KOMUNA E LIPJANIT - ZYRA PËR INFORMIM

LIPJANIN PIKËRISHT NË 22 VJETORIN E DITËS SË ÇLIRIMIT DO TA
NDEROJNË EDHE TRI SHTATORE TJERA, DËSHMORI TË KOMBIT HARADIN
BAJRAMI XHAVIT KOZHANI SI DHE HUMANISTIT RUZHDI SHABANI.



Lipjanin pikërisht në 22 vjetorin e Ditës së Çlirimit do ta nderojnë edhe tri shtatore tjera





Kryetari Imri Ahmeti së bashku me Kryetarin e Skenderait Bekim Jashari dhe bashkëpunor të tjerë kanë vizituar turneun e shahut që është mbajtur në ambientet e bibliotekës së qytetit, organizim ky për nderë të 22 vjetorit të çlirimit të Komunës së Lipjanit.





Kryetari i Komunës së Lipjani Imri Ahmeti i shoqëruar me bashkëpunëtor, gjatë ditës kanë bërë homazhe pranë shtatores së Komandantit Legjendar Adem Jashari, në sheshin e qytetit të Lipjanit me rastin e 14 qershorit, ditës së Dëshmorëve të Komunës së Lipjanit



Nderohen dëshmorët e Komunës së Lipjanit

Nën kujdesin e Kryetarit të Komunës, Imri Ahmeti, në Qendrën Kulturore "Tahir Sinani", në Lipjan është mbajtur akademi përkujtimore për nderë të 14 Qershorit, Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Lipjanit



Ekspozitë në sheshin “Adem Jashari” në Lipjan

Në kuadër të aktiviteteve të organizuara për shënimin e ditës së dëshmorëve të komunës së Lipjanit, në sheshin e qytetit “Adem Jashari”, u hap ekspozita e shoqatës së arteve pamore “Picasso”



Me rastin e 22 vjetorit të çlirimit të Komunës së Lipjanit, janë mbajtur aktivitete për shënimin e kësaj dite të rëndësishme duke filluar me një seancë solemne të Kuvendit të Komunës së Lipjanit



Promovohet libri PLOJË E MADHE" me autor Sefer Tasholli



I pari i Komunës së Lipjanit, Kryetari Imri Ahmeti qmoi lartë kontributin e autorit Tasholli duke thënë se ky libër është një dhuratë e mirë që sjell qytetarëve të Lipjanit e Sllovisë pikërisht në ditën e Çlirimit të qytetit tonë.

Kryetari Imri Ahmeti: Falenderoj Zëvendës Ambasadorin e SHBA-së në Kosovë dhe popullin e amerikan për mbështetje të vazhdueshme ndaj qytetarëve të vendit tonë



Kryetari i Komunës Imri Ahmeti, ka pritur Zëvendës Ambasadorin Amerikan, Nicholas J. Giacobbe, Drejtoreshën e MCC për Kosovë Sarah Olmstead dhe Petrit Selimi, shef Ekzekutiv Sfidat e Mileniumit në Kosovë për të inaguruar fillimin e punimeve për renovimin e objekteve shumëbanesore në qytetin e Lipjanit.



Kryetari Ahmeti ndanë 85 mijë euro për subvencionimin e 17 klubeve sportive



Dita e Informimit për Cilësinë e Ajrit në qytetin e Lipjanit



Edhe Lipjani sot është bërë pjesë e fushatës së ndërgjegjësimit në të gjithë vendin për ndotjen dhe cilësinë e ajrit, ku këtij aktiviteti i'u është bashkangjitur edhe Kryetari Imri Ahmeti me bashkëpunëtorë për të promovuar sloganin "Ajër më i pastër për shëndet më të sigurt", aktivitet që u zhvilluar në sheshin Adem Jashari në qytetin e Lipjanit.

Në Komunën e Lipjanit kanë filluar të mbahen dëgjimet publike lidhur me Kornizën Afatmesme Buxhetore 2022-2024



Gjatë këtyre takimeve, Drejtori për Buxhet dhe Financa, Latif Ramadani ka elaburuar kornizën afatmesme buxhetore 2022-2024 po ashtu ka pranuar kërkesat që kanë dal nga këto takime.

Mbahet shfaqja “Çelësi magjik” në Lipjan



Për ndër të 12 Qershorit Ditës së Çlirimit të Komunës së Lipjanit dhe 14 Qershorit Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Lipjanit në kujdesin e Kryetarit Imri Ahmeti në bashkëpunim me ojq ART-POLIS sot kanë filluar aktivitetet e ndryshme për të shënuar këto ditë.



AJËR I PASTËR PËR SHËNDET MË TË SIGURTË!

Drejtoresha e Drejtorisë Komunale e Arsimit, Elmaze Behluli gjatë ditës së sotme ka takuar pëfaqësuesit e projektit për Cilësinë e Ajrit, ku temë diskutimi ishte aktiviteti i Ditëve të Informimit për Cilësinë e Ajrit që do të organizohet në Lipjan me 10 qershor në sheshin Adem Jashari nga ora 10.00-16.00.

Qëllimi i këtyre ditëve të informimit është për të informuar publikun lidhur me rreziqet shëndetësore të shkaktuara nga ndotja e ajrit dhe masat që ata duhet ndërmarrë për të mbrojtur veten, duke ndryshuar sjelljen e tyre dhe duke u përpjekur të ulin nivelin e ndotjes së ajrit.

Kuvendi miraton Hartën Zonale të Komunës së Lipjanit 2021-2029

KOMUNA E LIPJANIT



Kuvendi Komunal i Lipjanit udhëhequr nga Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, sot ka zhvilluar punimet në mbledhjen e radhës në të cilën përveq pikave të rendit të ditës u ngritën dhe u diskutuan edhe shumë qështje të tjera.

Gjatë kësaj mbledhje po ashtu janë miratuar këto propozim vendime: Propozim vendim për lirim nga pagesa e taksave Komunale, propozim vendim për shpalljen e interesit publik për shpronësim të paluajtshmërive në funksion të ndërtimit të segmenteve rrugore “Afrim Zhitia”, “Mbreti Zog” dhe “Kongresi i Blinajës” në Lipjan, propozim vendim për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Lipjanit 2021-2029, propozim vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit.

Kryetari Imri Ahmeti së bashku me shefin e zyrës së BE-së në Kosovë Tomash Sunjog dhe me zyrtarë të tjerë vendor e ndërkombëtarë kanë qendruar në Janjevë



Kryetari I Komunës së Lipjanit Imri Ahmeti gjatë ditës ishte nikoqiri i përfaqësuesve të lartë të BE-së në Kosovë, ambasades kroate dhe përfaqësuesve të shumtë të misioneve të ndryshme vendor e ndërkombëtarë të cilët bashkërisht kanë vizituar Janjevën



**Kryetari Imri Ahmeti, ka qendruar në sallën e sporteve
“Better Life” në Lipjan, për të parë nga afër mbarëvajtjen e
procesit të vaksinimit të qytetarëve i cili po bëhet bazuar
në Planin e Veprimit të vaksinës kundër Covid-19**



Kryetari Imri Ahmeti me bashkëpunëtorë ka bërë homazhe dhe ka vendosur kurora me lule pranë varrit dhe bustit të Dëshmorit Ibrahim Krasniqi, në Smallushë duke kujtuar jetën dhe veprën e tij.



Komuna e Lipjanit vazhdon bashkëpunimin me UNICEF-in për “Komunën Mike për Femije”



Kryetari i Komunës Imri Ahmeti së bashku me Drejtoreshen e DKRS-së Anila Reçica, kanë pritur në takim zëvendës Shefen e zyrës së UNICEF Znj. Larissa Bruun, me të cilën kanë diskutuar për vazhdimin e Memorandumit të Mirekuptimit për “Komunën Mike për Fëmijë” deri në vitin 2025 atëherë sa zgjat edhe cikli i ri i Programit të UNICEF-it 2021-2025.

Kryetari Ahmeti priti në takim shefin e misionit të OSBE-së në Kosovë Michael Davenport



Kryetari i Komunës, Imri Ahmet, ka pritur në takim shefin e misionit të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Kosovë, ambasadorin Michael Davenport, me ç’ rast kanë biseduar lidhur me bashkëpunimin e deritanishëm që misioni i OSBE-së ka pasur me Komunën e Lipjanit.

Kryetari Imri Ahmeti i ka uruar mirëseardhje në Lipjan ambasadorit Michael Davenport, duke theksuar se Komuna e Lipjanit është mirënjohëse ndaj OSBE-së, të cilët në vazhdimësi kanë ofruar mbështetjen e nevojshme në drejtim të mbrojtjes, promovimit dhe përmirësimit të respektimit të të drejtave të njeriut në Kosovë si dhe ka nënvizuar rëndësinë e vazhdimit të bashkëpunimit edhe në të ardhmen.

Komuna e Lipjanit dhe organizata VoRAE koordinohen për vazhdimin e bashkëpunimit



Kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti së bashku me bashkëpunëtorë, ka pritur sot në takim drejtorin Ekzekutiv të organizatës "Voice of Roma, Ashkali and Egyptians", Isak Skenderi, donatoren nga Fondacioni Zvicerrian HEKS, Angela Elgimer dhe menaxherët e programit të banimit.

Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi i mundësisë për ndërtimin e qendrës për aktivitete shoqëror në fshatin Gadime e cila do të ndërtohet nga bashkëpunimi i Komunës me organizatën VoRAE. Po ashtu, temë diskutimi ishte edhe procesi i legalizimit dhe mundësia e trajtimit të vendeve jo formale në Komunën e Lipjanit.

Kryetari Imri Ahmeti ka mbajtur takim publik me qytetarë



Kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti, në sallën e Kuvendit Komunal ka mbajtur takim publik me qytetarët lipjanas, të cilët i ka njoftuar për punën e gjashtëmujorshit të parë të vitit 2021 të qeverisjes lokale dhe bashkarisht kanë diskutuar për të gjitha projektet, të arriturat por edhe për sfidat të cilat i kanë përcjellur gjatë kësaj periudhe kohore.

Kryetari Ahmeti, para qytetarëve e në këtë rast të rinjëve që ishin një numër i konsideruar të pranishëm në këtë takim ka prezantuar punët të cilat po bëhen në teren.

Po ashtu i pari i Lipjanit ka ftuar qytetarët që të jenë më bashkëpunues e më aktiv që nëpërmjet sugjerimeve, vërejtjeve dhe kërkesave të bëhen pjesë e pandashme e ndikimit në përmirësimin e jetës së gjithë qytetarëve të Komunës së Lipjanit.



BULETINI MUJOR



RR. SHQIPËRIA NR: 28 14000 LIPJAN, KOSOVË

TEL: 038 200 41 508

THIRR PA PAGESË 0 800 14 000

EMAIL: INFOKOMUNA.LIPJAN@RKS-GOV.NET